
TOP ALBANIA SH. A. NIPT: K01719005H
PASQYRAT FINACIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2019
[ADRESA: BULEVARDI DËSHMORËT E KOMBIT, QËNDRA NDËRKOMBËTARE
E KULTURËS, TIRANË]


Përmbajtja

<i>I.</i>	Pasqyra e pozicionit financiar	1
<i>II.</i>	Pasqyra e Performances (sipas natyres), [ardhura dhe shpenzime].....	3
<i>III.</i>	Pasqyra e ndryshimit e Ndryshimeve ne Kapitalin e vet	4
<i>IV.</i>	Pasqyra e fluksit te mjeteve monetare (metoda indirekte)	5
<i>V.</i>	Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare	6
I.	Informacion i përgjithshëm	6
A.	Parimet bazë për përgatitjen e pasqyrave financiare	6
B.	Politikat kryesore kontabile.....	8
1.	Transaksionet në monedhë të huaj	8
2.	Instrumentat financiare	8
3.	Inventaret	10
4.	Aktivët Afatgjatë Materiale (AAM) dhe Jo materiale (AAJM)	10
5.	Të ardhurat	11
6.	Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit	11
7.	Qiratë.....	11
8.	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare	11
9.	Tatimi mbi fitimin.....	12
10.	Fondet për pensione	12
11.	Transaksionet me palët e lidhura.....	12
12.	Provizionet	12
13.	Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara.....	12
14.	Krahasueshmëria e informacionit kontabel.....	12
15.	Mjetet Monetare.....	13
16.	Llogari të arkëtueshme dhe tjera të arkëtueshme	13
17.	Inventari	14
18.	Shpenzime te Shtyra.....	14
20.	Aktive Afatgjatë Materiale.....	14
21.	Detyrimet Afatshkurtër	15
22.	Detyrimet Afatgjatë.....	15
23.	Kapitali dhe rezervat	16
24.	Të ardhura nga veprimtaria e shfrytëzimit	16
25.	Shpenzime të personelit	16
26.	Shpenzime për Amortizimin dhe Zhvlerësimi	17
27.	Shpenzime te tjera shfrytezimi	17
28.	Shpenzime financiare	18
29.	Rezultati Tatimor dhe Fitimi /(humbja) i vitit ushtrimor	18
30.	Palët e Lidhura	19
31.	Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara.....	19


Tiranë më, 27/07/2020

DETYRIMET DHE KAPITALI	Shënimet	Date: 31.12.2019	Date: 31.12.2018
Detyrime afatshkurtra	21		
Titujt e huamarrjes			
Detyrime ndaj institucioneve te kredise-ASH		1,163,730	3,379,712
Aktetime ne avance per porosi		1,286,567	1,767,129
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit		58,359,006	46,279,650
Deftesa te pagueshme		-	-
Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit *		-	-
Te pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa pjesmarrese		-	-
Te pagueshme ndaj punonjeseve dhe sigurimeve shoqerore/shendetsore		2,109,738	2,366,692
Te pagueshme per detyrime tatimore		633,436	752,379
Te tjera te pagueshme		-	-
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara		-	-
Te ardhura te shtyra		-	-
Provizione		-	-
Totali i detyrimeve afatshkurtra		63,552,477	54,545,562
Detyrime afatgjata			
Titujt e huamarrjes		-	-
Detyrime ndaj institucioneve te kredise-AGJ	22	1,429,041	1,554,147
Aktetime ne avance per porosi		-	-
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit		-	-
Deftesa te pagueshme		-	-
Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit *		-	-
Te pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa pjesmarrese		-	-
Te pagueshme ndaj punonjeseve dhe sigurimeve shoqerore/shendetsore		-	-
Te pagueshme per detyrime tatimore		-	-
Te tjera te pagueshme		-	-
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara		-	-
Te ardhura te shtyra		-	-
Provizione		-	-
Provizione per pensione		-	-
Provizione te tjera		-	-
Detyrime tatimore te shtyra		-	-
Totali i detyrimeve afatgjata		1,429,041	1,554,147
Detyrime totale		64,981,518	56,099,709
Kapitali dhe Rezervat			
Kapitali i nenshkruar	23	140,587,000	140,587,000
Primi i lidhur me kapitalin		-	-
Rezerva rivleresimi		-	-
Rezerva te tjera			
Rezerva ligjore		14,007,726	13,893,144
Rezerva statutare		-	-
Rezerva te tjera		3,020,346	3,020,346
Diferenca nga perkthimi i monedhes ne veprimtari te huaja		-	-
Fitimi/(humbja) e pashperndare		-	-
Fitimi/(humbja) e periudhes		(107,820)	2,291,645
Totali i kapitalit qe i takon pronareve njesise ekonomike		157,507,252	159,792,135
Interesa jo-kontrollues		-	-
Totali i kapitalit		157,507,252	159,792,135
TOTALI I DEYRIMEVE DHE KAPITALIT		222,488,770	215,891,844

Hartuese e Pasqyrave Financiare


Ardiana Peposhi

Administratore


Vjollca Hoxha

Tirane më, 27/07/2020



II. Pasqyra e Performances (sipas natyres), [ardhura dhe shpenzime]

Pasqyra e Performances (sipas natyres)		Date: 31.12.2019	Date: 31.12.2018
Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit	24		
Te ardhurat nga aktiviteti kryesor		66,257,839	73,709,582
Te ardhurat nga aktiviteti dytesor 1		-	-
Te ardhurat nga aktiviteti dytesor 2		-	-
Te ardhurat nga aktiviteti dytesor 3		-	-
Te tjera te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit		7,909,248	1,621,217
Te ardhura nga ndryshimi ne inventarin e mallrave dhe prodhimit ne proces		-	-
Te ardhura nga puna e kryer nga njesia ekonomike per qellimet e veta dhe e kapitalizuar		-	-
Te ardhura te tjera te shfrytezimit		-	-
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme		-	-
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme		-	-
Te tjera shpenzime		-	-
Shpenzime te personelit	25	-	-
Paga dhe shperblime		(28,294,324)	(25,409,230)
Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetsore		(3,483,956)	(3,248,777)
Shpenzimet per pensionet		-	-
Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale		-	-
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	26	(12,648,958)	(12,005,162)
Shpenzime te tjera shfrytezimi	27	(28,787,696)	(31,064,413)
Te ardhura te tjera		-	-
Te ardhura nga njesite ekonomike brenda grupit*		-	-
Te ardhura nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesmarrese		-	-
Te ardhura nga investimet dhe huate e tjera ne njesi ekonomike brenda grupit, pjese e aktiveve afatgjata *		-	-
Te ardhura nga investimet dhe huate e tjera ne njesi ekonomike ku ka interesa pjesmarrese, pjese e aktiveve afatgjata		-	-
Interesa te arketueshem dhe te ardhura te tjera te ngjashme nga njesi ekonomike brenda grupit *		-	-
Interesa te arketueshem dhe te ardhura te tjera te ngjashme nga njesi ekonomike ku ka interesa pjesmarrese		-	-
Zhvleresim i aktiveve financiare dhe investimeve financiare te mbajtura si aktive afatshkurtra		-	-
Shpenzime financiare	28	-	-
Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme		(261,806)	(227,397)
Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme per tu paguar tek njesite ekonomike brenda grupit *		-	-
Shpenzime te tjera financiare		(263,404)	(467,320)
Pjesa e fitimit/(humbjes) financiare nga pjesmarrjet te tjera (pershkruaj)		-	-
Fitimi/(humbja) para tatimit		426,945	2,908,499
Tatimi mbi fitimin		-	-
Tatimi mbi fitimin e periudhes		(534,765)	(616,854)
Tatim fitimi i shtyre		-	-
Pjesa e tatim fitimit te pjesemarrjeve		-	-
Fitimi/(Humbja) e periudhes/vitit (A)	29	(107,820)	2,291,645
Totali i te ardhurave gjithepershiresë per periudhen/vitin (A+B)		(107,820)	2,291,645

Hartuese e Pasqyrave Financiare

Ardiana Peposhi

Administratore

Vjollca Hoxha

27/07/2020




III. Pasqyra e ndryshimit e Ndryshimeve në Kapitalin e vet

	Kapitali i nënshkruar	Primi i lidhur me kapitalin Rezerva rritësitimi	Rezerva Ligjor	Rezerva të tjera	Diferenca nga përfitimi i menedhjes në veprimtari të huaja	Fitimet/ (humbjet) e pasqperandara	Fitim/(humbje) e periudhes	Totali	Interesa jo-kontraktuale	Totali
Pozicioni financiar në fillim 01 Janar 2018	140.587.000	13.851.419	280.388			1.947.180	834.503	157.500.489		157.500.489
Efekt i ndryshimeve në politikat kontabile										
Pozicioni financiar i rideklaruar në fillim	140.587.000	-	13.851.419	280.388	-	1.947.180	834.503	157.500.489	-	157.500.489
Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse të periudhes:										
Fitim/(humbje) e periudhes 2018										
Te ardhura të tjera gjithëpërfshirëse							2.291.645	2.291.645		2.291.645
Tatime aktuale dhe të shtyra të njohura drejtpërdrejt në kapital										
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën							2.291.645	2.291.645		2.291.645
Transaksione për pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:										
Emetim i kapitalit të nënshkruar										
Dividende të shpërndara										
Percaktime të tjera për rezultatit e periudhes të vitit 2017			41.725	2.739.958		(1.947.180)	(834.503)			
Totali i transaksioneve për pronarët e njësisë ekonomike			41.725	2.739.958		(1.947.180)	(834.503)			
Pozicioni financiar në fund (viti paraardhës) 31 Dhjetor 2018	140.587.000	-	13.893.144	3.020.346	-	(0)	2.291.645	159.792.135	-	159.792.135
Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse të periudhes:										
Fitim/(humbje) e periudhes 2019										
Te ardhura të tjera gjithëpërfshirëse							(107.820)	(107.820)		(107.820)
Tatime aktuale dhe të shtyra të njohura drejtpërdrejt në kapital										
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën							(107.820)	(107.820)		(107.820)
Transaksione për pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:										
Emetim i kapitalit të nënshkruar										
Dividende të shpërndara										
Percaktime të tjera për rezultatit e periudhes të vitit 2018			114.582				(2.177.062)	2.177.062		2.177.062
Totali i transaksioneve për pronarët e njësisë ekonomike			114.582				(2.291.644)	(2.177.062)		(2.177.062)
Pozicioni financiar në fund (viti aktual)	140.587.000	-	14.007.726	3.020.346	-	(0)	(107.819)	157.507.253	-	157.507.253

Hartuese e Pasqyrave Financiare


 Ardiana Peposhi

Administratore


 Vjollca Hoxha



IV. Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare (metoda indirekte)

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare (metoda indirekte)	Date: 31.12.2019	Date: 31.12.2018
Fluksi mjeteve monetare nga/perdorur në aktivitetin e shfrytëzimit:		
Fitimi/(Humbja) e periudhës		
Rregullime për shpenzimet jo-monetare:	426,945	2,908,499
Shpenzimet financiare jomonetare	-	-
Shpenzime për tatimin mbi fitimin jo-monetar (diferenca shpenzim - pagese gjatë periudhës)	(534,765)	(616,854)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi AAM	12,648,958	12,005,162
Shpenzime konsumi dhe amortizimi AAJM	-	1,649,086
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	-	-
Zhvlerësimi i të drejtave të arketueshme	-	-
Ulje në vlerën neto të realizueshme për inventaret	-	-
Shpenzime të konstatuara	-	-
Shpenzime të shtyra	6,556,382	-
Provizione për shpenzime	-	-
Te ardhura të konstatuara	-	-
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese		
(Fitim)/humbja nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	-	-
(Fitim)/humbja nga investimet në pjesëmarrje	-	-
Interesa të fituara	-	-
Ndrryshim në aktivitet dhe detyrimet e shfrytëzimit	-	-
Renie/(Rritje) në të drejtat e arketueshme dhe të tjera	(16,192,438)	(24,579,255)
Renie/(Rritje) në inventar	1,872,177	3,119,843
Rritje/(Renie) në detyrime të pagueshme	11,598,794	7,167,042
Rritje/(Renie) në detyrime për punonjësit	(256,954)	210,444
Rritje/(Renie) në detyrime Tatimore	(118,943)	116,141
Mjete monetare neto nga/ perdorur në aktivitetin e shfrytëzimit	16,000,156	1,980,108
Fluksi i mjeteve monetare nga/ perdorur në aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(11,338,203)	(1,364,676)
Arkitime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	-	-
Para të perdorura për blerjen e filjaleve (netuar me shumën e	-	-
para të arketuara nga shitja e filjaleve (netuar me shumën e	-	-
mjeteve monetare pjesë e aktiveve neto të shitura)	-	-
Pagesa për blerjen e investimeve të tjera Garanci AMA	(1,000,000)	-
Arkitime nga shitja e investimeve të tjera	-	-
Dividende të arketuara	-	-
Interesa të arketuara	-	-
Mjete monetare neto nga/perdorur në aktivitetin e investimit	(12,338,203)	(1,364,676)
Fluksi i mjeteve monetare nga/perdorur në aktivitetin e financimit		
Arkitime nga emetimi i kapitalit të nenshkruar	-	-
Rritje rezerva Ligjire nga rezultati	-	-
Hua të arketuara	-	370,287
Pagesa e kostove të transaksionit që lidhet me kredite dhe huatë	-	-
Riblerje e aksioneve të veta	-	-
Pagesa e aksioneve të perdorura si kolateral	-	-
Pagesa e huave	(2,341,088)	-
Pagese e detyrimeve të qirase financiare	-	-
Interes i paguar	-	-
Dividende të paguar pronarëve të njesive ekonomike meme	(2,177,063)	-
Dividende të paguar interesave jokontrrollues	-	-
Mjete monetare neto nga/perdorur në aktivitetin e financimit	(4,518,151)	370,287
Rritje/(renie) neto në mjetet monetare dhe ekuivalente me to	(856,198)	985,719
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim	1,833,550	847,831
Efekt i luhatjeve të kurseve të kembimit të mjeteve monetare	-	-
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fund	977,352	1,833,550

Hartuese e Pasqyrave Financiare

Ardiana Peposhi

Administratore

Vjollca Hoxha



Tiranë më, 27/07/2020

V. Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare

I. Informacion i përgjithshëm

Subjekti¹ "TOP ALBANIA" (Emri Tregtar) është krijuar si SH.A, më datë 16/05/2000 dhe e ka Selinë në adresën: Bulevardi Dëshmoret e Kombit, Qendra Ndërkombetare e Kulturës, Tiranë. Administrator i Shoqërisë është Vjollca Hoxha.
NIPT/NUIS: K01719005H.

Objekti i këtij subjekti është: *Veprimtari radiofonike që përfshin prodhimin, transmetimin e programeve dhe informacioneve të çdo lloji me anë të zërit, sinjaleve të koduara, shkrimit të destinuar për publikun.*
Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës (sh.a. me dy nivele)

1. Ornela Gjoka
2. Denis Dyrnjaja
3. Dorian Gjorgji
4. Eno Popi
5. Elma Balashi
6. Ledion Liço
7. Dorjana Lato
8. Ardiana Peposhi

Numri mesatar i punonjësve: 39 punonjës

Personi përgjegjës për përpunimin e informacionit për hartimin e pasqyrave financiare: Znj. Ardiana Peposhi, e punësuar në subjekt.

Auditues Ligjore: Znj. Fatime ALLIU me nr. Liçense 166, datë 21.09.2007; z. Ilia Çeçe me nr. Liçense 266 date 27.08.2012.

Referuar Nenit 4 të Ligjit 25/2019 dt.10.05.2019 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" "TOP Albania" sh.a kategorizohet në: *njësi ekonomike e vogël.*

Kuadri ligjor: Ligjit Nr.25/2018 dt.10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare". Pasqyrave Financiare janë hartuar sipas Standardeve Kontabël Kombëtare SKKP Nr.2, i ndryshuar.

Karakteristikat cilësore të pasqyrave financiare sipas SKKP Nr.1 janë:

- Parimin e paraqitjes me besnikeri;
 - Parimin e përparësisë së përmbajtjes ekonomike mbi formën ligjore.
 - Parimin e pa-anëshmërisë pa asnjë influencim të qëllimshëm;
 - Parimin e maturisë pa optimizem të tepruar, pa nën e mbivlerësim të qëllimshëm;
 - Parimin e plotësisë duke paraqitur një pamje të vërtetë e të drejtë të Pasqyrave Financiare;
 - Parimin e qëndrueshmërisë për të mos ndryshuar politikat e metodat kontabël;
 - Parimin e krahasueshmërisë duke siguruar krahasimin midis dy periudhave;
- Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj: 01.01.2019-31.12.2019.

A. Parimet bazë për përgatitjen e pasqyrave financiare

a) Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar (SKKP).

b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e vlerësimit të specifikuar nga SKKP për çdo klasë të aktiveve, detyrimeve, të performancës dhe ardhurave gjithpërfshirëse. Bazat e matjes përshkruhen në detaje në politikat kontabël të mëposhtme. Sipas parimeve të kontabilitetit në Shqipëri deklarimet financiare janë përgatitur mbi bazën e konceptit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Mbajtja e kontabilitetit, i cili përfshin si regjistrimet

¹ Shënim: Në këto pasqyra financiare shpjegojmë se përdorimi i fjalëve -subjekt, -shoqëri është ekuivalent me emërtimin Top Albania sh.a.

kontabël dhe sistemin e tij, mbahen në mënyrë të kompjuterizuar, me ane të një programi të kontabilitetit.

c) Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë

d) Krahasueshmëria

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabël të Shoqërisë dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas sistemit kontabël Shqiptar. Të dhënat krahasuese pasqyrojnë gjendjen e pozicionit financiar të shoqërisë në 31 Dhjetor 2019 [Ref.SKKP Nr.1].

a) Qëndrueshmëria e Paraqitjes

Një njësi ekonomike ruan paraqitjen dhe klasifikimin e zërave në pasqyrat financiare nga njëra periudhë në tjetrën.

b) Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë egzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar gjatë.

Zotëruesit ligjor dhe përfituesit e kapitalit aksioner të shoqërisë "Top Albania" sh.a. shprehin gatishmërinë që shoqëria të plotësojë detyrimet e tyre financiare në çdo kohë dhe t'i sigurojnë asaj gjithë mbështetjen që mund të nevojitet për të mbajtur nivelin e kapitalit dhe likuiditetit në nivele të tilla që të përmbushin detyrimet e saj në përputhje me parimin e vijimësisë të përshtatshëm për atë aktivitet që ajo kryen.

c) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKKP-të kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të jenë të ndryshme nga këto vlerësime. Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen

▪ Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e klientëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të klientëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së klientëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

▪ Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, duke gjykuar për ndodhjen e ngjarjes, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

▪ Zhvlerësimi i inventarëve

Shoqëria vlerëson gjendjen e inventarit në qarkullim të ulët dhe inventarin i cili ka humbur vlerën e përdorimit për shkak të zhvillimeve teknologjike apo arsyeve të tjera, me synim për të përcaktuar masën e zhvlerësimit të inventarit, bazuar në përdorimin e ardhshëm të tij dhe në llogaritjen e vlerës neto të realizueshme. Në rast se vlera neto e realizueshme e inventarit është

më e ulët se vlera kontabël neto, ekziston një tregues që inventari është i zhvlerësuar. Shoqëria përdor gjykimin e saj për të përcaktuar masën e zhvlerësimit.

B. Politikat kryesore kontabile

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës në të cilin është kryer transaksioni. Aktivitetet dhe pasivitetet monetare në monedhë të huaj në datën e mbylljes së bilancit janë rivlerësuar në monedhën funksionale sipas kursit të shpallur nga Banka e Shqipërisë në datën e mbylljes së periudhës ushtrimore. Diferencat që rrjedhin si rezultat i rikonvertimit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat kryesore të përdorura në konvertimin e gjendjeve të bilancit emërtuar në monedhë të huaj në datën e hartimit të bilancit janë si më poshtë (në LEK):

	31.12.2019	31.12.2018
Kurse e këmbimit		
Euro/Leke	121.77	123.42
USD/Leke	108.64	107.82
GBP/Leke	143.00	132.98

2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

▪ Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

▪ Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

▪ Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Për llogaritë e pagueshme, te pa paguara dhe te pa kërkuara për me shume se pese vjet për të cilat shoqëria bazuar në të dhënat dhe komunikimin me palën tjetër nuk ka ndonjë pritshmëri për

shlyerjen e këtyre detyrimeve, gjykon se detyrimet e me sipërme nuk duhen njohur si te tilla por i njeh si të ardhura te vitit qe vijne nga fshirja e tyre.

▪ **Hua të marra dhe të dhëna**

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

▪ **Vlera e drejtë**

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël, Shoqëria nuk ka aplikuar vlerë të drejtë.

▪ **Të tjera**

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

▪ **Zhvlerësime të aktiveve financiare**

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

▪ **Kapitali aksionar**

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale.

▪ **Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare**

Vlerat kontabile të aktiveve jofinanciare të shoqërisë, përveç inventarëve rishikohen në çdo datë raportimi për të parë nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabile e një aktivi është më e madhe se vlera e rikuperueshme e tij. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi është me e madhja mes vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së drejtë minus koston e shitjes. Në matjen e vlerës në përdorim, flukset e pritshme të parasë skontoohen në vlerën e aktuale duke përdorur normen e skontimit përpara taksës që paraqet vlerësimin e tregut për vlerën në kohë të parasë dhe riskun specifik të aktivitetit.

Për humbjet nga zhvlerësimi të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohet në çdo datë raportimi nëse ka ndonjë tregues sipas të cilit humbja është ulur ose nuk ekziston më. Një humbje nga zhvlerësimi anulohet nëse kanë ndodhur ndryshimet në vlerësimet e bëra për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi anulohet deri në atë masë që vlera kontabël e aktiveve të mos kalojë vlerën kontabël të aktiveve, minus amortizimin, që do të ishte përcaktuar nëse zhvlerësimi nuk do të kishte ndodhur.

• **Ç`regjistrimi instrumentave financiare**

Aktivitetet financiare së bashku me fondin rezervë të zhvlerësimet ç`regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria

transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit.

Detyrimet financiare ç'regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërise perfundojnë, skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

3. Inventaret

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

4. Aktivet Afatgjate Materiale (AAM) dhe Jo materiale (AAJM)

▪ *Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjate materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Programi i blerë që është pjesë përbërëse në funksionimin e një pajisjeje është kapitalizuar si pjesë e pajisjes.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjate materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

• *Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjate materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjate materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

• *Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Normat e amortizimit për vitin 2019 janë si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Toka	-	Nuk amortizohet
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Instalime Teknike	Vlera e mbetur	20%
Mobilje dhe orendi	Vlera e mbetur	20%
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Te tjera	Vlera e mbetur	20%

Vlera e mbartur e aktiveve afatgjate materiale rishikohen për zhvlerësim kur ngjarje apo ndryshime në rrethanat tregojnë se vlera kontabël mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë, kur vlera kontabël tejkalon vlerën e rikuperueshme të vlerësuar aktivet paraqiten me vlerën e tyre të rikuperueshme, e cila është më e larta mes vlerës së tyre të drejtë minus koston për shitje dhe vlerës së tyre në përdorim.

Amortizimi nuk aplikohet për tokën dhe punimet në proces që nuk janë në funksionim.

- **Çregjistrimi**

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

Aktivet Afatgjata Jo-materiale (AAJM-t)

Një aktiv jo-material njihet nëqoftëse, e vetëm nëqoftëse: është e mundshme që përfitimet e pritshme ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij aktivi do të rrjedhin tek njësia ekonomike; dhe kosto e aktivit mund të matet me besueshmëri

Një njësi ekonomike vlerëson mundësinë e përfitimeve të pritshme ekonomike në të ardhmen duke përdorur supozime të arsyeshme dhe të mbështetura që përfaqësojnë vlerësimin më të mirë të drejtimit të kushteve ekonomike që do të ekzistojnë gjatë jetës së dobishme të aktivit.

Njësi ekonomike përdor gjykimin për të vlerësuar shkallën e sigurisë bashkëngjitur flukseve të përfitimeve ekonomike në të ardhmen që i atribuohen përdorimit të aktivit mbi bazën e evidencës së disponueshme në kohën e njohjes fillestare, duke i dhënë më shumë rëndësi evidencës nga të tretët. Një aktiv jo-material matet fillimisht me koston.

- **Mbajtja e mëpasshme**

Mbas njohjes fillestare, një aktiv jo-material mbartet me koston e tij minus çdo amortizim të akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Aktivet jo-materiale amortizohen me normën 15% mbi koston historike.

5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate dhe të ardhura nga veprimtari të tjera jooperative.

7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Pagesat e bëra për qiratë operative njihen në të ardhura ose shpenzime në mënyrë lineare gjatë afatit të qirasë.

8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (2018: 15%).

10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

13. Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

14. Krahasueshmeria e informacionit kontabel

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (rregullohen) në konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Ndryshimet janë kryer për të paraqitur më mirë natyrën e biznesit të Shoqërisë. Ato aplikohen retrospektivisht.

15. Mjetet Monetare

Balancat e mjeteve monetare më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si në vijim:

Llogarite Bankare Sipas bankave	Monedha	31 Dhjetor 2019		31 Dhjetor 2018			
		Ekivalenca ne leke	Vlefte ne Monedhe	Ekivalenca ne leke	Vlefte ne Monedhe		
Raiffeisen Bank (ALL)	LEK	53.094	All	53.094	2.138	All	2.138
Banka Kombetare Tregtare (ALL)	LEK	5.107	All	5.107	8.721	All	8.721
Alfa Bank (ALL)	LEK	(2.567)	All	(2.567)	933	All	933
Intesa San Paolo (ALL)	LEK	140.862	All	140.862	254.847	All	254.847
Societe Albanja (ALL)	LEK	3.261	All	3.261	1.344	All	1.344
Tirana Bank (ALL)	LEK	13.558	All	13.558	53	All	53
Credins Bank (ALL)	LEK	137.687	All	137.687	4.926	All	4.926
Raiffeisen Bank (EUR)	EUR	4.322	€	35	4.512	€	4.512
Raiffeisen Bank GBP	GBP	(2.717)	£	(19)	(665)	£	(5)
Banka Kombetare Tregtare (EUR)	EUR	7.077	€	58	186.380	€	186.380
Intesa San Paolo (EUR)	EUR	1.970	€	16	(2.323)	€	(2.323)
Union Bank (EUR)	EUR	8.707	€	71,50	3.105	€	25,16
Tirana Bank (EUR)	EUR	3.071	€	25,22	412	€	3,39
Credins Bank (EUR)	EUR	1.030	€	8,46	689.486	€	5.662,20
Raiffeisen Bank (USD)	USD	(515)	\$	(4,74)	(1.646)	\$	(13,34)
Vlera monetare, në lekë (M)	LEK						
ARKA EURO	EUR						
Totali		373.946			1.152.223		

Mjete monetare banke	Monedha	31 Dhjetor 2019		31 Dhjetor 2018			
		Ekivalenca ne leke	Vlefte ne Monedhe	Ekivalenca ne leke	Vlefte ne Monedhe		
Llogari rrjedhese	Lekë	351.003	All	351.003	272.962	All	272.962
Llogari rrjedhese	EURO	26.176	€	215	881.573	€	194.260
Llogari rrjedhese	USD	(515)	\$	(5)	(1.646)	\$	(13)
Llogari rrjedhese	PAUND	(2.717)	£	(19)	(665)	£	(5)
Totali		373.946			1.152.223		

Mjete monetare ne arke	Monedha	31 Dhjetor 2019		31 Dhjetor 2018			
		Ekivalenca ne leke	Vlefte ne Monedhe	Ekivalenca ne leke	Vlefte ne Monedhe		
Arka Ne LEK	Lekë	601.701	All	601.701	679.600	All	679.600
Arka Ne EURO		1.704	€	14	1.728	€	14
Totali		603.405			681.327		

16. Llogari të arkëtueshme dhe tjera të arkëtueshme

Gjendja e llogarive të arkëtueshme e të tjera arkëtueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohet si më poshtë:

Kerkesa te arketueshme	Monedha	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
		Vlera ne leke	Vlera ne leke
Kliente -nga aktiviteti i shfrytëzimit	Lekë	123,510,168	107,876,647
Totali		123,510,168	107,876,647

Te tjera kerkesa te arketueshme	Monedha	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
		Vlera ne leke	Vlera ne leke
Paradhënie për punonjësit	Lekë	254,158	254,158
Itan Hoxha (EUR)	Lekë	861,826	-
Lorela Hoxha	Lekë	1,969,054	1,969,054
Te drejta ndaj aksionereve	Lekë	15,756,324	15,756,324
Dividentë për t'kthyer	Lekë	(305,258)	-
Debitorë të tjerë, kreditorë të tjerë	Lekë	1,442,200	1,439,852
Totali		19,978,304	19,419,388

Ortakët e shoqërise janë debitorë kundrejtë saj për Shumen prej 15,756,324 leke.

17. Inventari

Gjendja e llogarive të inventarit më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohet si më poshtë:

Inventare	Monedha	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
		Vlera ne leke	Vlera ne leke
Lendet e para	Lekë	31,529	52,548
Mallra	Lekë	2,776,737	4,627,895
Totali		2,808,266	4,680,443

18. Shpenzime te Shtyra

Shpenzime te shtyra	Monedha	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
		Vlera ne leke	Vlera ne leke
Shpenzime te periudhave te ardhme	Lekë	-	6,556,382
Totali		-	6,556,382

Shuma prej 6,556,382 lekë, në 31.12.2018 është identifikuar nga ana jonë si shpenzime rikosntruksioni për zyrat e shoqërisë.

19. Aktive Financiare

Aktive Financiare	Monedha	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
		Vlera ne leke	Vlera ne leke
Tituj te tjere te huadhenies-garanci AMA	Lekë	1,000,000	-
Totali		1,000,000	0

20. Aktive Afatgjate Materiale

Aktivet Afatgjate Materiale (AAM)

	Ndertesa	Impiante dhe makineri	Mjete transporti	Te tjera aktive te qendrueshme	Totali
31 Dhjetor 2018	28,056,000	127,517,026	5,845,383	61,231,493	222,649,902
Shtesa		3,531,885	0	1,249,935	4,781,820
Transferime	6,556,382				6,556,382
Pakesime					
31 Dhjetor 2019	34,612,382	131,048,911	5,845,383	62,481,428	233,988,104
Amortizimi Akumuluar					
31 Dhjetor 2018	10,355,702	93,116,309	5,249,109	38,843,776	147,564,896
Shtesa	1,212,834	7,527,656	119,255	3,701,127	12,560,872
Pakesime				0	
31 Dhjetor 2019	11,568,536	100,643,965	5,368,364	42,544,903	160,125,768
Vlera Neto					
31 Dhjetor 2018	17,700,298	34,400,717	596,274	22,387,717	75,085,006
31 Dhjetor 2019	23,043,846	30,404,946	477,019	19,936,525	73,862,337

Shuma prej 6,556,382 lekë, gjendje ne pozicionin shpenzime te shtyra ne 31.12.2018 është identifikuar nga ana jonë si shpenzime rikosntruksioni për zyrat e shoqërisë.

Top Albania sh.a., NIPT: K01719005H
 Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2019
 (Të gjitha shumat janë në LEK, nëse nuk shprehet ndryshe).

Aktive Afatgjate Jo Materiale (AAJM)	Koncensione, patenta, licensa, makra tregtare, te drejta dhe aktive te ngjashme	Totali
Vlera Bruto		
31 Dhjetor 2018	440,428	440,428
Shtesa	0	-
Transferime		-
Pakesime		-
31 Dhjetor 2019	440,428	440,428
Amortizimi Akumuluar		
31 Dhjetor 2018	0	0
Shtesa	88,086	88,086
Pakesime		
31 Dhjetor 2019	88,086	88,086
Vlera Neto		
31 Dhjetor 2018	440,428	440,428
31 Dhjetor 2019	352,342	352,342

21. Detyrimet Afatshkurtër

Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

Detyrime afatshkurtra:	Monedha	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
		Vlera ne leke	Vlera ne leke
Aktetime ne avance per porosi	Lekë	1,286,567	1,767,129
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	Lekë	58,359,006	46,279,650
Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shendetsore	Lekë	2,109,738	2,366,692
Te pagueshme per detyrime tatimore	Lekë	633,436	752,379
Totali		62,388,747	51,165,850

Detaje detyrimet tatimore

Detyrime ndaj buxhetit	Monedha	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
		Vlera ne leke	Vlera ne leke
Sigurime shoqerore dhe shendetsore	Lekë	413,389	477,187.0
Kontribute per sigurime shoqerore	Lekë	83,158	0
Tatim mbi të ardhurat personale	Lekë	189,502	154,974.0
Tatim mbi fitimin	Lekë	(26,282)	115,627.0
Shteti- TVSh për tu paguar	Lekë	(26,328)	4,891.0
Shteti TVSH e zbritshme	Lekë		
Shteti TVSH e pagueshme	Lekë		
Tatimi në burim	Lekë	(3)	(300.0)
Totali		633,436	752,379

Detyrime afatshkurtra:	Monedha	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
		Vlera ne leke	Vlera ne leke
Detyrime ndaj institucioneve te kredise-ASH	Lekë	1,163,730	3,379,712
Totali		1,163,730	3,379,712

22. Detyrimet Afatgjate

Detyrime afatgjate:	Monedha	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
		Vlera ne leke	Vlera ne leke
Detyrime ndaj institucioneve te kredise-AGJ	Lekë	1,429,041	1,554,147
Totali		1,429,041	1,554,147

23. Kapitali dhe rezervat

		<u>31.12.2019</u>			
	Nr.Pjeseve	Vlera nominale e aksionit	Struktura e Kapitalit regjistruar	Kapitali i aksionar	
Itan Hoxha	14058.75	1000	10.00%	14058750	
Lorela Hoxha	14058.75	1000	10.00%	14058750	
Sara Hoxha	14058.75	1000	10.00%	14058750	
Redia Hoxha	14058.75	1000	10.00%	14058750	
Zhuljeta Lamaj	28117	1000	20.00%	28117000	
Ervin Zeneli	56235	1000	40.00%	56235000	
	140,587.00		100%	140,587,000	

		<u>31.12.2018</u>			
	Nr.Pjeseve	Vlera nominale e aksionit	Struktura e Kapitalit regjistruar	Kapitali i aksionar	
Itan Hoxha	14058.75	1000	10.00%	14058750	
Lorela Hoxha	14058.75	1000	10.00%	14058750	
Sara Hoxha	14058.75	1000	10.00%	14058750	
Redia Hoxha	14058.75	1000	10.00%	14058750	
Zhuljeta Lamaj	28117	1000	20.00%	28117000	
Ervin Zeneli	56235	1000	40.00%	56235000	
	140,587.00		100%	140,587,000	

Rezerva ligjore per Shumen prej 14,007,726 Lekë
 Rezerva te tjera per Shumen prej 3,020,346 Lekë
 Fitim/Humbje e Vitit per Shumen prej (107,820) Lekë

Veprimet në llogaritë e kapitalit janë të mbështetura me dokumenta ligjore.

24. Të ardhura nga veprimtaria e shfrytëzimit

Te ardhurat	Monedha	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
		Vlera ne leke	Vlera ne leke
Te ardhurat nga aktiviteti kryesor	Lekë	66,257,839	73,709,582
Te ardhura te tjera	Lekë	7909248.2	1,621,217
Totali		74,167,088	75,330,799

25. Shpenzime të personelit

Në këtë zë përfshihen shpenzimet si më poshtë:

Shpenzimet e Personelit	Monedha	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
		Vlera ne leke	Vlera ne leke
Shpenzimet per pagat	Lekë	28,294,324	25,409,230
Sigurimet shoqerore shendetesore	Lekë	3,483,956	3,248,777
Totali		31,778,280	28,658,007

26. Shpenzime për Amortizimin dhe Zhvlerësimi

Amortizimi	Monedha	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
		Vlera ne leke	Vlera ne leke
Amortizimi dhe Zhvleresimet	Lekë	12,648,958	12,005,162
Totali		12,648,958	12,005,162

27. Shpenzime te tjera shfrytezimi

Në këtë zë përfshihen shpenzimet si më poshtë:

Shpenz. Te tjera nga vep.e shfrytezimit	Monedha	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
		Vlera ne leke	Vlera ne leke
Inventar i imet	Lekë	1,872,177	3,119,843
Energji per Stacionet	Lekë	5,737,341	-
Energji per Zyrat Qendrore	Lekë	3,962,000	3,309,580
Shpenzime per abonime(gazeta)	Lekë	45,185	-
Realizim Spote televizive	Lekë	-	2,410,019
Transmetim ne platformen digitalb	Lekë	-	4,791,968
Qira për Stacionet	Lekë	3,317,398	1,032,210
Shpenzime qera ambientesh	Lekë	609,812	1,723,433
Mirëmbajtje për njësitë e shitjes, të shpërndarjes	Lekë	178,822	622,685
Mirëmbajtje për administratën	Lekë	63,465	155,607
Sigurime njësi administrative	Lekë	37,970	166,783
Sigurime per mjete	Lekë	93,039	18,985
Shpenzime per materiale pastrimi	Lekë	113,003	128,523
Shpenzime per Kancelari	Lekë	93,497	35,010
Shpenzime te tjera	Lekë	394,260	4,152,583
Komisione te ndermjetesve dhe honorare	Lekë	399,323	2,312,950
Komisione per Reklama	Lekë	511,508	-
Publicitet, reklama	Lekë	30,000	365,000
Reklama Top Channel	Lekë	330,000	-
Udhëtime, dieta për shpërndarjen	Lekë	31,000	-
Shpenzime per Telefoni Fikse	Lekë	34,063	37,294
Shpenzime per Telefoni	Lekë	327,944	365,234
Shpenzime karburanti	Lekë	2,000	149,167
Shpenzime për shërbimet bankare	Lekë	164,717	147,548
Shpenzime auditimi	Lekë	240,000	240,000
Taksa per automjetet	Lekë	5,460	-
Taksa, tarifa doganore	Lekë	6,500	-
Taksa dhe tarifa vendore	Lekë	443,440	387,330
Taksa e regjistrimit	Lekë	1,991,600	2,295,080
Shpenzime të tjera për personelin	Lekë	782,654	-
Shpenzime te panjohura	Lekë	2,477,886	1,401,667
Shpenzime te periudhave te meparshme (nga kontrolllet)	Lekë	456,048	-
Gjoha dhe dëmshpërblime	Lekë	86,183	46,829
Vlera kontabel e aktive afatgjata te shitura	Lekë	3,949,400	1,649,086
Totali	Lekë	28,787,696	31,064,413

Në zërin shpenzime auditimi janë përfshirë tarifrat e audituesve për auditimin e PF 2017, respektivisht auditueset ligjore Nexhmije Cela dhe Fatime Alliu nga 120,000 lekë secila. Për auditimin e PF 2018, audituesit ligjore Fatime Alliu dhe Ilia Cece respektivisht nga 120,000 lekë secili.

28. Shpenzime financiare

Shpenzime financiare	Monedha	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
		Vlera ne leke	Vlera ne leke
Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme	Lekë	261,806	227,397
Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme per tu paguar tek njesite ekonomike brenda grupit *	Lekë	-	-
Shpenzime te tjera financiare	Lekë	263,404	467,320
Totali		525,209	694,717

Shpenzime te tjera financiare	Monedha	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
		Vlera ne leke	Vlera ne leke
Humbje nga këmbimet dhe perkthimet valutore		128450	481,128
Humbje nga këmbimet dhe perkthimet valutore		-	87,952
Të ardhura nga interesat		166	(107)
Fitim nga kembimet valutore		134,788	(101,653)
Totali		263,404	467,320

29. Rezultati Tatimor dhe Fitimi /(humbja) i vitit ushtrimor

Rezultati tatimor	Monedha	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
		Vlera ne leke	Vlera ne leke
Fitimi para tatimit	Lekë	426,945	2,908,499
Shpenzime te panjohura	Lekë	3,138,154	1,203,859
Fitimi fiskal	Lekë	3,565,099	4,112,358
Tatim fitimi (15 %)	Lekë	(534,765)	(616,854)
Fitimi Neto		(107,820)	2,291,645

Detyrime ndaj buxhetit	Monedha	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
		Vlera ne leke	Vlera ne leke
Shpenzime te panjohura	Lekë	2,477,886	1,157,030
Shpenzime te periudhave te meparshme (nga kontrollet)	Lekë	456,048	
Gjoha dhe dëmshpërblime	Lekë	86,183	46,829
Shpenzime të tjera korente	Lekë	118,037	
Totali		3,138,154	1,203,859

Per llogaritjen shpenzimeve per tatim fitimin jane mbajtur prasysh kriteret e percaktuara nga ligjit "Per tatimin mbi te ardhurat".

30. Palët e Lidhura

	31 Dhjetor 2019		31 Dhjetor 2018	
	Të arketueshme	Të Pagueshme	Të arketueshme	Të Pagueshme
Top Channel sh.a	16.510.565	1.101.600	16.510.565	720.000
Digit Alb Sh.a	1.392.327	13.123.323	1.354.450	6.347.977
VGA sh.p.k	1.054.653			
Valltina sh.p.k	5.570.033			
Top Gold	330.800		330.800	
	24.858.378	14.224.923	18.195.815	7.067.977

	31 Dhjetor 2019		31 Dhjetor 2018	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Top Channel sh.a	-	381.600	-	360.000
Digit Alb Sh.a	6.266.931	6.775.346	8.731.861	5.750.362
VGA sh.p.k	284.316		54.557	
Valltina sh.p.k	1.754.646		1.711.112	
Top Gold	-		-	
	8.305.893	7.156.946	10.497.531	6.110.362

Informacione te tjera	31.12.2019	31.12.2018
Administrator	729.816	729.816
Keshilli Mbikqyres	-	-
	Nr	Nr
Administratore	1	1
Keshill Mbikqyres	8	8
	-	-

31. Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

- Çështje gjyqësore**

Më 31 Dhjetor 2019 Shoqëria/subjekti nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

- Detyrime tatimore**

Librat e Shoqërisë/subjektit nuk janë audituar nga organet tatimore për periudhën 2019. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

- Ngjarje pas datës së bilancit**


Gjatë fillimit të Marsit 2020, shfaqja e Covid-19, në Shqipëri, ka krijuar vështirësi në funksionimin e bizneseve në Shqipëri për shkak të masave të marra nga Qeveria Shqiptare për parandalimin e përhapjes së këtij virusi. Kjo ngjarje ka një ndikim të menjëhershëm në shumë hallka të zinxhirit ekonomik. Deri në datën e leshimit të këtyre pasqyrave financiare kjo ngjarje është konsideruar si ngjarje jo me efekte rregulluese për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019.

Nuk ka ngjarje të tjera mbas datës së raportimit të cilat mund të kërkojnë rregullime apo paraqitje të informacionit në pasqyrat financiare të njësisë Ekonomike.

Hartuese e Pasqyrave Financiare


Ardiana Peposhi

Administratore


Vjollca Hoxha

27/07/2020

